

DEKRET
Nr.1701, datë 9.1.1997

**PËR NJË SHITESË NË DEKRETIN NR.1074, DATË 21.4.1995 "PËR SHPËRBËRJEN E
POLICISË FINANCIARE DHE KRIJIMIN E POLICISË DOGANORE DHE POLICISË
TATIMORE" MIRATUAR ME LIGJIN NR.7938, DATË 24.5.1995**

Në mbështetje të nenit 28 pika 19 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave

DEKRETOJ:

Neni 1

Në nenin 8 të dekretit nr.1074, datë 21.4.1995, pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"Konfiskon, në bazë të urdhrit të nxjerrë nga organi epror i saj, dhjetë fishin e fitimit spekulativ të realizuar nga subjektet në prag festash zyrtare.

Në kuptim të kësaj pike "fitim spekulativ" do të quhet çdo fitim në cilido furnizim malli a shërbimi, çmimi i të cilit ngrihet dukshëm mbi atë të tregut në atë periudhë dhe që nuk është pasojë e ndonjë ndryshimi në politikën fiskale, tarifa, taksa e tatime në atë lloj malli a shërbimi".

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi më 10.1.1997.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha